

V E N D I M
Nr.221, datë 10.4.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.671, DATË 15.12.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PËRCAKTIMIT
TË VERBËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.671, datë 15.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Pagesa e mjekëve dhe e anëtarëve të tjerë të komisionit të bëhet në bazë të pjesëmarrjes në çdo komision dhe, përkatësisht, për kryetarin e komisionit në masën 23 për qind, ndërsa për anëtarët e komisionit 20 për qind të pagës mujore, sipas strukturës së pagave të përcaktuara në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, kreu I.1, lidhja nr.1, emërtimi “mjek”, por jo më shumë se një pagë mujore e këtij emërtimi. Komisioni mbledhet jo më shumë se katër herë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e Shërbimit Social Shtetëror.

3. Në të gjitha pikat e vendimit, emërtimi “Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale”, ndryshohet në “Shërbimi Social Shtetëror”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano